



BERZH financon me 50 milionë euro programin e rrugëve lokale

Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) do të financojë me një shumë prej 50 milionë eurosh programin „Rrugët dytësore dhe lokale“ në Shqipëri. Kredia në fjalë është pjesë e një projekti të koordinuar prej 137 milionë eurosh që do të mbështesin projektin e qeverisë Shqiptare, i cili është në zbatim që prej vitit 2008. Projekti do të jetë bashkëfinansim me një tjetër kredi nga Banka Evropiane e Investimeve me po 50 milion euro dhe me grante të Bashkimit Evropian nga IPA 2010 e 2011 me shumën prej 33 milion eurosh. Ndërkaq, një grant prej 4 milion eurosh nga Uestern Balkan Investment Framework do të mbulojë kosto të tjera të lidhura me projektin si projektim-supervizion, asistencë teknike etj. Rreth 650 km rrugë dytë-

sore e lokale parashikohet të rindërtohen nga ky projekt gjatë 5 viteve të ardhshme. Projekti „Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale“ është një bashkëfinansim i Bankës Botërore dhe donatoreve të tjerë e po realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me një vlerë të përafërt prej 400 milion USD. Ky projekt synon të përmirësojë infrastrukturën rajonale dhe lokale në vend, si dhe të rrisë aksesin ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rreth 1500 km-ve rrugë. Aktualisht, janë në proces implementimi 210 km rrugë rajonale dhe lokale, ndërkohë që gjatë vitit 2010 parashikohet të jenë rehabilituar apo të jenë nën rikonstruksion 340 km rrugë.

Pollo: Post – Telekomunikacioni, sektori kampion i rritjes ekonomike

Ministri i Shtetit: „Do të përfitojnë konsumatorët“

Post – Telekomunikacioni ishte sektori që shënoi rritjen ekonomike më të lartë gjatë tremujorit të tretë, fundvitit të 2009-ës. Ajo shënoi një rritje prej 34.3 përqind krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2008. Ky sektor, krahasuar me tremujorin e dytë 2009 u rrit me 20.5 përqind. Ministri i Shtetit z.Genc Pollo në një deklaratë për mediat tha ndër të tjera se, „Do të doja t’ ju informoja për zhvillime inkurajuese në sektorin e telekomunikacioneve. Ky është sektori kampion i ekonomisë shqiptare, pasi është rritur në tremujorin e tretë me 34,3% përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, ose është rritur me 20.5 përqind, krahasuar me tremujorin paraardhës. Pra, kemi sektorin më dinamik të ekonomisë tonë. Kjo rritje është, ndër të tjera, efekt i futjes në treg të operatorit të tretë mobil, i cili ka rritur konkurrencën, dhe prandaj ka ulur çmimet dhe përmirësuar cilësinë tek të tërë këta operatorë. Me aktivizimin e operatorit të katërt në gjashtëmujorin e parë 2010 dhe me ofrimin e portabilitetit të numrit dhe të standardit teknik 3G (third generation, brezi i tretë) nga mesi i vitit besoj se do të kemi zhvillime të rëndësishme. Zhvillime të rëndësishme nga të cilat në radhë të




parë do të fitojë konsumatori.“ Në grupin e post telekomunikacionit përfshihen aktivitetet ekonomike si: Aktivitete të

postës kombëtare; Aktivitete të tjera të korrierëve përveç atyre të postave kombëtare; Telekomunikacioni. Në këtë grup futen të

gjitha kompanitë që kryejnë transmetimin e: tingujve, pamjes, të dhënave ose informacioneve të tjera me rrugë kabllore,

satelitore, etj, pra edhe kompanitë që kryejnë shërbime internet. Ecuria pozitive e degës së post-telekomunikacionit gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009 ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh ku mund të përmendim: futjen në treg të kompanisë së tretë celulare në vitin 2008, e cila ka shënuar një rritje të lartë e të vazhdueshme të vlerës së shitjes në çdo tremujor; ulja e çmimeve të shërbimeve të komunikacionit të lëvizshëm dhe atij fiks gjatë periudhës së vitit 2008 – 2009. Indeksi i çmimeve të këtij grupi ka pësuar një rënie të konsiderueshme gjatë këtyre dy viteve duke ndikuar drejt - përsëdrejti në rritjen e volumit të këtyre shërbimeve. Ulja e çmimeve për të mirat e konsumit shoqërohet me një rritje të sasisë së përdorimit të tyre duke u mundësuar konsumatorëve që të përfitojnë më shumë nga këto të mira. Rritja e vlerës së shitjeve nga kompanitë kryesore të këtij grupi. Kompanitë që kanë si aktivitet kryesor, aktivitetin postar apo atë të komunikacionit, kanë patur një rritje të konsiderueshme të shitjeve të tyre gjatë këtij tremujori. Këta faktor kanë ndikuar që ky sektor të vazhdojë të ketë një rritje të lartë edhe gjatë këtij tremujori.



Dega e Post - Telekomunikacionit							
Tremujori	2008q1	2008q2	2008q3	2008q4	2009q1	2009q2	2009q3
Indeksi i çmimit për aktivitetin e post Telekomunikacionit	97.40	97.34	94.36	78.67	78.52	78.45	78.95

Dega e Post - Telekomunikacionit							
Tremujori	2008q1	2008q2	2008q3	2008q4	2009q1	2009q2	2009q3
Vlerat me çmime konstante	8,885	10,555	11,539	13,755	13,358	12,809	15,501